



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primitur / Dostiguar Prijeto / Pristalo Received / Dostigov	01.11.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	It. Prot. It. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SKPMSHCK	6818/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1154/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi, anëtarë; me Ardita Perçuku Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1154/2023, të datës 12.09.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit KD.Nr.26/2023 të datës 21.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.10.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1154/2023, e datës 12.09.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KD.Nr.26/2023 i datës 21.08.2023, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje referuar vetëm ankuesi), i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 12.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.Nr.26/2023, të datës 21.08.2023, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimin ankimor së vendimi i kundërshtuar më ankesë nuk është i drejtë dhe është nxjerrë në kundërshtim me Vendimin e KPMSHCK-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6059/2023, të datës 12.09.2023, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.Nr.26/2023 të datës 21.08.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 4845/2023 të datës 20.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.Nr.26/2023 të datës 31.05.2023 të Komisionit Disiplinor të

Shërbimit Korrektues të Kosovës; Orarin e oficerëve për ndërrimin e ditës të datës 19.04.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.06.2023, Përgjigje në ankesë e datës 22.06.2023 për Këshillin nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës si: Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 i datës 10.01.2023; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e nënshkruar me datë 30.06.2020; Inicimi i procedurës disiplinore me nr. reference SHKK/BSL.001/2023 i datës 27.04.2023; E-maili i datës 20.04.2023- njoftim nga Udhëheqësi për Siguri në Burgun e Sigurisë së Lartë për Mbikëqyrësin e lartë; Vendimi për zhvillimin e hetimeve me numër protokoll 518/2023 të datës 20.04.2023 i lëshuar nga Drejtori i Burgut të Sigurisë së Lartë; Raport hetimi me numër protokoll 537/2023 të datës 26.04.2023 i Komisionit Hetimor; Raporti Hetimor për mosdorëzimin e çelësave nga zyrtari korrektues, shpjegimi i shkurtër i rastit i datës 25.04.2023; Procesverbali i datës 24.04.2023 nga Komisioni Hetimor; Deklarata e datës 19.04.2023 nga ankuesi, Procesverbal i seancës së datës 24.05.2023 i Komisionit Disiplinor dhe rasti i nxjerrjes së çelësave jashtë institucionit nga M.B i datës 20.03.2023, Rregullat lidhur me Kontrollin e Çelësave të Drejtorit të Burgut të Sigurisë së Lartë, maj 2015, se bashku me detyrat dhe përgjegjësitë e oficerit korrektues në BSL.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe si i njëjti ushtron pozitën e punës Zyrtar Korrektues në Burgun e Sigurisë së Lartë.

Me tej nga provat materiale të kësaj çështje rezultojnë së Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit, me datë 27.04.2023, përmes shkresës më numër reference SHKK/BSI-001/2023, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit, bazuar në propozimin e Komisionit Hetimor, i dhënë në Raportin hetues më numër protokoll 537 të datës 26.04.2023, e sipas të cilit raport rezultojnë se ankuesi me datë 19.04.2023 ka qenë në detyrë në Pavionin B1-C1 më orar tetë orësh. Pas përfundimit të orarit të punës në ora 16:00 ankuesi ka marrë me vete në shtëpi çelësat e krahut C1, i njëjti kishte vërejtur që ka me vete çelësat e krahut C1, me ç'rast ka lajmëruar dhomën e kontrollit dhe menjëherë është urdhëruar nga mbikëqyrësi i ndërrimit që ti kthejë çelësat dhe së ankuesi ashtu kishte vepruar.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues, me Vendimin më numër KD.nr.26/2023, të datës 31.05.2023, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 ndërlidhur me nenin 25 të Ligjit Nr.06-L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 58 pika 3.4 dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, duke i shqiptuar masën disiplinore “*ndalimi 20% e pagës për periudhën një (1)muaj*”.

Kundër këtij vendimi, ankuesi më datë 20.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, me Vendimin A.nr.869/2023, të datës 01.09.2023, ka kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues, në ri-procedurë me Vendimin më numër KD.nr.26/2023, të datës 21.08.2023, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 ndërlidhur me nenin 25 të Ligjit Nr.06-L - 114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 58 pika 3.4 dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, duke i shqiptuar masën disiplinore “*ndalimi 20% e pagës për periudhën një (1)muaj*”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që vendimi KD.nr.26/2023, i datës 21.08.2023 i Komisionit Disiplinor, nuk është i drejtë dhe është nxjerrë në kundërshtim me vendimin e KPMSHCK-së. Shton se, në ditën kur ka ndodhur rasti nuk ka qenë mbikëqyrës por andaj edhe i njëjti nuk ka mundur te inicioj procedurë disiplinore ndaj meje pasi që nuk ka qene në dijeni për rrethanat e rastit. Çelësat e krahut C1 i kam harruar në gjepin e jaknes sime, dhe menjëherë për një periudhe kohore prej 15-20 minuta i kam kthyer ato dhe së kjo ka qenë vetëm një harresë e vogël dhe jo për ndonjë qëllim tjetër. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj Vendimin KD.Nr.26/2023 të datës 21.08.2023, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës disiplinore të nëpunësve civilë përkatësisht nenin 45 më të cilin përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore dergjët veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht edhe organi kompetent publik me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil është i obliguar që të veprojnë në pajtueshmëri me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, mos diskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshëm dhe të arsyeshme, si dhe parimin e informimit dhe ndihmës aktive siç është përcaktuar me nenet 4, 5, 6, 7, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, Kolegji mori parasysh edhe dispozitat e nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilat janë përcaktuar në mënyrë shprehimore shkeljet disiplinore, ku parashihet se: *Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. ... Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë..."*

Në kuptim të kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e kundërshtuar me ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Vendimi me numër

KD.nr.26/2023, i datës 21.08.2023, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazohet në vërtetim të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të drejtë të dispozitave materiale, ngase sipas provave të lëndës përkatësisht sipas Njoftimit të Mbikëqyrësit të lartë (i ndërrimit) të datës 19.04.2023 si dhe Raportit Hetimor të Komisionit Hetimor të datës 24.04.2023, konstatohet se ankuesi me datë 19.04.2023, në përfundim të orarit të punës në ora 16:⁰⁰ ka dal nga institucioni përkatësisht Burgu i Sigurisë së Lartë dhe ka marr me vete çelësat e Krahut C1, dhe së i njëjti pasi ka shkuar në shtëpi ka vërejtura së çelësat gjenden në jakne, të cilat me pastaj i ka kthyer në institucion, veprime qe bien ndesh me Rregullat e Brendshme lidhur me kontrollin e çelësave në të gjitha burgjet, rrjedhimisht sipas rregullave të brendshme maj 2015 të lëshuara nga Drejtori i Burgut të Sigurisë së Lartë, pika 5 lidhur me çelësat ka përcaktuar se: *6.Të gjithë çelësat që përkohësisht nuk i janë dhënë personelit do të ruhen në një vend të kyçur dhe të mbahen në llogari në çdo kohë.7. Çelësat duhet të numërohen nga oficeri para se ta përfundoj ndërrimin. 8. Ai/ajo duhet ta njoftoj oficerin të cilit ia dorëzon postin se ku janë çelësat. 9. I gjithë personeli i autorizuar me çelësa duhet të nënshkruhen në librin për Kontrollimin e çelësave.10.Të gjithë çelësat do të jepen nga një zonë e kontrolluar.10.Për të gjitha çelësat që i jepen personelit duhet mbajtur shënim duke përdorur: a.Regjistër për dhënien e çelësave; ose b. Sistem me etiketë çelësi duke përdorur procedurat e mëposhtme: i.Të gjithë personelit duhet t'i jepen etiketa çelësash me emrin e tyre ose numër unik identifikimi; ii. Numri i identifikimit duhet të regjistrohet së bashku me emrin e personit që i është caktuar; iii. Kur merret çelësi, anëtarit i personelit që e merr çelësin duhet t'i japë etiketën e çelësit anëtarit të personelit që e jep çelësin, i cili do ta vendosë atë në varësen ku ishte çelësi. iv. Kur çelësi kthehet në vendin ku është morë, etiketa e çelësit duhet t'i kthehet anëtarit të personelit. Për çdo humbje të etiketës së çelësave duhet të informohet Mbikëqyrësi i Lart Përgjegjës. Përkatësisht, në rastin konkret nuk është respektuar procedura e kontrollit të çelësave nga ana e ankuesit, kështu që mbi këtë bazë të konstatimit, rrjedhë së veprimi i ankuesit me rastin e marrjes së çelësave me vete pra nxjerrjes së çelësave jashtë institucionit, janë veprime në kundërshtim edhe me dispozitat e nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se:“2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, Kolegji i Këshillit konstaton së Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46, paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe në këtë mënyrë ka shqiptuar masën disiplinore në pajtim me nenin 50 paragrafin 4 të këtij ligji, rrjedhimisht nisur nga ky konstatim është i pa bazuar pretendimi ankimor së vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk është i drejtë.*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit konstaton së nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se procedura disiplinore ndaj tij nuk ka mundur të iniciohet nga Mbikëqyrësi pasi qe i njëjti nuk ka qenë atë ditë, sepse, sipas shkresave të lëndës konstatohet së Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka iniciuar procedurë disiplinore bazuar në propozimin e Komisionit hetimor të datës 25.04.2023, dhe një veprim i tilla procedural është në pajtim të plotë më nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka përcaktuar se: *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil... ”.*

Përmbledhur si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1154/2023

Ardita Percuku Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.